



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 26.12.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMIN E CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
FOTOVOLTAIKE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2MW “TEKSOEN 1” DHE  
VEPRAVE NDIHMËSE”, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE  
POVELÇË, BASHKIA FIER.

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Idi 2005” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2MW “Teksoen 1” dhe veprave ndihmëse”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Idi 2005” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

E.DI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJBA ROKA



Nënshkruar më datë 16/04 / 2024